REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# BASHKIA LIBRAZHD

## PROCESVERBAL

## KONSULTIM PUBLIK PËR PROJEKT-BUXHETIN DHE PAKETËN FISKALE TË BASHKISË LIBRAZHD 2024

I mbajtur më date 04/10, ora 16:00, në dëgjesën mbi projekt-buxhetin dhe Paketën Fiskale të Bashkisë Librazhd për vitin 2024 për Njësinë Administrative Lunik. Takimi u zhvillua në Lunik.

**Të pranishëm në takim ishin:**

- Kryetari i Bashkisë Z. Mirgen Dishu
- Nënkryetari i Bashkisë Z. Jetmir Fjuka
- Drejtori i Bujqësisë Z. Hysni Hoxha.
- Drejtuesha Taksave Z. Lindita Shuli
- Drejtoresha e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Alzana Hoxha
- Administratori i Njësisë Z. Arden Kodralliu.
-

Takimi u hap nga Kryetari i Bashkisë i cili i njohi pjesëmarrësit me prioritetet e Bashkisë të tilla si:

- Mirëmbajtja e rrugëve, mirëmbajtja e kanaleve vaditëse.
- Vazhdimi i asfaltimit të rrugës Lunik - Prevallë.
- Mirëmbajtja e shkollave dhe kopshteve.
- Shtrimi me beton i hapësirave, rrugëve që kanë pjerrësi të lartë.
- Ulja e taksave për biznesat e vogla, zero taksë për bizneset me sipërmarrës deri në moshën 25 vjeç.
- Ndërtimi i shkollës gjithpërfshirëse Lunik

Pas fjalës së përfaqësuesve të tjerë te bashkise, takimi u pasua me sesionin pyetje dhe përgjigje me qytetarët. Kryesisht banorët e zonës kishin ankesa dhe sugjerime që lidheshin me :

- Energjë elektrike në fshatin Mëxixë dhe Banoreç.
- Sistemimi i rrugës që lidh Zgoshtin me fshatin Jetëm.
- Sistemimi, ndërhyrje në kanalin vaditës në Lunik.
- Sistemimi, asfaltimi i rrugës Lunik – Prevallë.
- Ndërhyrje me fadromë në rrugët e brendshme të lagjeve në Zgosht, Jetëm, Lunik, Prevallë.
- Hapje e një rruge në Dranovicë.
- Ndërtim ujësjellësi, ndërtim ure që lidh Kostanjën me Prevallin dhe Neshtën.

Duke i falënderuar qytetarët për angazhimin dhe përfshirjen e tyre në të mirën e përbashkët të zhvillimit të zonës, përfaqësuesit e Bashkisë garantuan se idetë dhe sugjerimet e pjesëmarrësve në takim do të diskutohen për tu implementuar gjerësisht në projektet në vazhdim.

Elona Kasi